



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2026/0290**  
**Data e Vendimit: 20.05.2026**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Albi Company" SH.P.K kundër vendimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Prizrenit LOT I Shtëpia e familjes Luboteni, Prizren dhe LOT II Shtëpia e Xhevdet Gashit, Suharekë, Prizren” me numër të prokurimit: 207-25-9835-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Kulturës RS dhe ÇJK, Kryesuesi i Sekretariatit Ardian Behra, me datën: 19. 05. 2026, mori këtë:

## **Vendim**

I. Hedhet si e parakohshme, ankesa e OE "Albi Company" SH.P.K me nr. të protokollit 2026/0290, e datës 04.05.2026, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Prizrenit LOT I Shtëpia e familjes Luboteni, Prizren dhe LOT II Shtëpia e Xhevdet Gashit, Suharekë, Prizren” me numër të prokurimit: 207-25-9835-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Kulturës RS dhe ÇJK, në cilësi të AK-së.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- Ministria e Kulturës RS dhe ÇJK që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Prizrenit LOT I Shtëpia e familjes Luboteni, Prizren dhe LOT II Shtëpia e Xhevdet Gashit, Suharekë, Prizren” me numër të prokurimit: 207-25-9835-5-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

III. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimt të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

*-Faktet dhe rrethanat procedurale-*

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 04.05.2026, ka pranuar ankesën lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Prizrenit LOT I Shtëpia e familjes Luboteni, Prizren dhe LOT II Shtëpia e Xhevdet Gashit, Suharekë, Prizren” me numër të prokurimit: 207-25-9835-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Kulturës RS dhe ÇJK, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

Me 29.10.2025, Ministria e Kulturës RS dhe ÇJK në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05-Njoftimin për kontratë.

Me datën 23.03.2026 AK me vendimin B58 ka shpallur fitues OE “Albi Company” SHPK. Kundër vendimit të AK-së me datën 30.03.2026 kërkesë për rishqyrtim ka parashtruar OE pjesëmarrës “Ideal Partners” SH.P.K të cilën AK me datën 14.04.2026 AK e aprovuar dhe aktivitetin e prokurimit e ka kthyer në rivlerësim.

Me datën 17.04.2026, Operatori Ekonomik "Albi Company" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK kundër vendimit për kërkesën për rishqyrtim të AK-së drejtuar OE “Ideal Partners” SH.P.K.

Me datën 04.05.2026, Ankuesi (me të dhëna si më lartë) ka parashtruar ankesë në OSHP me numër protokolli 0290/2026.

*- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit të cituar si në pikën I të dispozitivit, pas pranimit të ankesës, shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha provave dhe shkresave të lëndës, OSHP sqaron se Ankuesi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK të parakohshme, gjegjësisht të palejuar.

Me datën 23.03.2026 AK Ministria e Kulturës RS dhe ÇJK me vendimin B58 për dhënie të kontratës ka shpallur fitues OE “Albi Company” SHPK. Kundër vendimit të AK-së me datën 30.03.2026 kërkesë për rishqyrtim ka parashtruar OE pjesëmarrës “Ideal Partners” SH.P.K të cilën AK me datën 14.04.2026 AK e aprovuar dhe aktivitetin e prokurimit e ka kthyer në rivlerësim.

Operatori ekonomik pa e pritur njoftimin zyrtar të AK-së për rivlerësim të aktivitetit të prokurimit menjëherë pas publikimit të vendimit lidhur me kërkesën për rishqyrtim të OE tjetër pjesëmarrës “Ideal Partners” është ka parashtruar direkt kërkesë për rishqyrtim në AK.

Sipas nenit 60 par 1 Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni “kërkesat për rishqyrtim” brenda afateve të mëposhtme: b) *Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0).*

*Sipas nenit 63. 1. 2 AK mund të miratojë një kërkesë për rishqyrtim si të bazuar kurdo qe kërkesa ndërlidhet me vendimin e AK për dhënie të kontratës, ndërkaq sipas nenit 63.1.3 a. Kurdo qe miratimi i kërkesës ndërlidhet me vendimin e AK për dhënie të kontratës (sipas paragrafit 63.1.2), pezullimi i tillë do të përfundojë para skadimit të një periudhe prej të paktën 10 ditë kalendarike nga data e publikimit të vendimit të AK. Pas vendimit për miratim të kërkesës, AK do të përdorë formularin B58 për publikim të anulimit të vendimit paraprak dhe vendimin për dhënie/shpërblim të kontratës ta kthej në ri-vlerësim.*

Pra, sipas nenit 63. 1. 2 OE ka qenë dashur të presë që AK të publikoj vendimin B58 për rivlerësim të aktivitetit të prokurimit dhe pastaj të parashtrojë kërkesë për rishqyrtim në AK dhe jo të parashtrojë kërkesë për rishqyrtim menjëherë pas vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim të një operatori ekonomik tjetër pjesëmarrës në aktivitet të prokurimit. Si e tillë kjo ankesë konsiderohet si e parakohshme në AK.

Autoritetit Kontraktues – Ministria e Kulturës RS dhe ÇJK, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Prizrenit LOT I Shtëpia e familjes Luboteni, Prizren dhe LOT II Shtëpia e Xhevdet Gashit, Suharekë, Prizren” me numër të prokurimit: 207-25-9835-5-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- **AK - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- **OE - "ALBI COMPANY" SH.P.K**
- Arkivës së OSHP-së: